REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA
KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
NR.PR.NO. 01 / 647
DAT.DT. 21.06.2023
PRISHTINË - A

**Këshilli Gjyqësor i Kosovës,**

Në mbështetje të nenit 7 paragrafit 1.24 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe nenit 39 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 06/L – 054 për Gjykatat, nenit 211 paragrafi 3 i Kodit Nr. 08/L-032 të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 30 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 03/2020 mbi Organizimin dhe Veprimtarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më datën 12 qershor 2023,

**Miraton:**

# RREGULLORE NR. 07/2023

# PËR PROCEDURËN E CERTIFIKIMIT, EMËRIMIT, KUSHTET, TË DREJTAT, DETYRIMET, SHPËRBLIMIN DHE DISIPLINIMIN E PËRKTHYESVE DHE INTERPRETËVE GJYQËSORË

## KAPITULLI I
## DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

### Neni 1
### Qëllimi

Me këtë rregullore përcaktohen procedurat e certifikimit dhe emërimit, kushtet, të drejtat, detyrimet dhe disiplinimi për përkthyes dhe/apo përkthyes dhe interpret gjyqësorë të certifikuar dhe emëruar, lartësinë e shpërblimit për punën e tyre, si dhe largimin nga regjistri.

### Neni 2
### Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj rregullore zbatohen ndaj të gjithë kandidatëve të cilët aplikojnë në Këshill për certifikim dhe emërim si përkthyes dhe/apo përkthyes dhe interpret gjyqësor, përkthyesve dhe/apo përkthyesve dhe interpreterve gjyqësorë të certifikuar dhe emëruar, si dhe ndaj të gjithë subjekteve bartëse të procesit siç përcaktohet me këtë rregullore.

## Neni 3
## Parimet e përgjithshme

Kjo rregullore zbatohet në pajtim me parimin e mos diskriminimit, trajtimit të barabartë, përfaqësimit gjinor dhe etnik, procesit të promovimit, profesionalizmit, integritetit, transparencës, pavarësisë, paanshmërisë dhe meritokracisë.

## Neni 4
## Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin:

1.1. **Ligji** – Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;
1.2. **Këshilli**- Këshillin Gjyqësor të Kosovës, ashtu siç përcaktohet me Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;
1.3. **Sekretariati** - Sekretariatin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës siç është përcaktuar në Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;
1.4. **Komisioni përzgjedhës** – komision i themeluar nga Këshilli, përgjegjës për zhvillimin e procedurave për certifikimin dhe emërimin e përkthyesve dhe/apo përkthyeseve dhe interpreteve gjyqësor.
1.5. **Komisioni për rishqyrtim** – komision i themeluar nga Këshilli përgjegjës për shqyrtim të ankesave të kandidatëve në procesin për certifikim dhe emërim të përkthyesve dhe /apo përkthyesve dhe interpretëve gjyqësorë, të paraqitura kundër vendimeve të nxjera nga komisioni përzgjedhes;
1.6. **Komisioni disiplinor** – komision i themeluar nga Këshilli përgjegjës për zhvillimin e procedurave disiplinore për përkthyes dhe/apo përkthyes dhe interpret gjyqësorë të certifikuar dhe emëruar;
1.7. **Komisioni për ankesa** – komision i themeluar nga Këshilli përgjegjës për shqyrtimin e ankesave nga përkthyesit dhe/apo përkthyesit dhe interpretet gjyqësorë të certifikuar dhe emëruar, të paraqitura kundër vendimeve të nxjerra nga Komisionit Disiplinor;
1.8. **Drejtori i përgjithshëm** - Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës siç parashihet në Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;
1.9. **Anëtar i komisionit** - anëtarin e emëruar nga Këshilli i cili kryen detyrat dhe përgjegjësitë në pajtim me këtë rregullore;
1.10. **Anëtar rezervë i komisionit** – anëtarin e emëruar nga Këshilli i cili zëvendëson anëtarët e komisionit në rast të konfliktit të interesit apo raste të tjera të pengesave eventuale gjatë ushtrimit të detyrës si anëtarë;
1.11. **Sekretar i komisionit** – udhëheqësi i zyrës së përkthimeve i cili ofron mbështetje profesionale dhe administrative të nevojshme për Komisionin përzgjedhës dhe komisionin për rishqyrtim, duke përfshirë edhe detyrat tjera në zbatim të kësaj rregullore;
1.12. **Përkthyes gjyqësor** - çdo individ i certifikuar dhe emëruar sipas kësaj rregullore që kryen rolin e lehtësuesit të komunikimit me anë të përkthimit të dokumenteve të shkruara gjyqësore dhe jo gjyqësore;
1.13. **Interpret gjyqësor** - është çdo individ i certifikuar dhe emëruar sipas kësaj

rregullore që kryen rolin e lehtësuesit të komunikimit me anë të interpretimit në procedurë gjyqësore, ose në rastet kur interpretimi është i nevojshëm për zhvillimin e procedurës gjyqësore;

1.14. **Subjekte bartëse të procesit** - anëtarët e komisioneve të parapara me këtë rregullore, kandidatët për përkthyes dhe/apo interpretet gjyqësorë, përkthyesit dhe/apo interpretet gjyqësorë të certifikuar dhe emëruar si dhe të gjithë zyrtaret përgjegjës të Këshillit të cilët janë të përfshirë në këtë proces;

1.15. **Çift i gjuhëve** – dy gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës ose një gjuhë zyrtare e Republikës së Kosovës dhe një gjuhë e huaj, si dhe nga njëra gjuhë zyrtare në tjetrën, si dhe anasjelltas;

1.16. **Gjuha A** – është gjuha burimore e një teksti ose dokumenti të shkruar nga i cili është kryer përkthimi në gjuhën e synuar;

1.17. **Gjuha B** – është gjuha e synuar në të cilën një tekst ose dokument i shkruar është përkthyer nga gjuha burimore;

1.18. **Përvojë e punës** - në kuptim të kësaj rregullore është përvoja në përkthim dhe mësimdhënie, përfshirë sektorin privat, publik si dhe në organizata vendore dhe ndërkombëtare.

2. Shprehjet e përdorura në njëjës e kanë të njëjtin kuptim edhe në shumës. Fjalët e përdorura në një gjini përfshijnë edhe gjininë tjetër.

## Neni 5
## Profesioni i përkthyesit dhe/apo përkthyesit dhe interpretit gjyqësorë të certifikuar dhe emëruar

1. Profesioni i përkthyesit dhe/apo përkthyesit dhe interpretit gjyqësorë të certifikuar dhe emëruar nga Këshilli ushtrohet nëpërmjet kryerjes së shërbimit në gjykata në përputhje me këtë rregullore.

2. Profesioni i përkthyesit dhe/apo përkthyesit dhe interpretit gjyqësorë të certifikuar dhe emëruar nga Këshilli duhet të kryhet vetëm nga personi fizik që është certifikuar dhe emëruar nga Këshilli për kryerjen e kësaj veprimtarie, në përputhje me kushtet e parashikuara me këtë rregullore me përjashtim të rasteve të parapara në nenin 26 të kësaj rregullore.

## Neni 6
## Organi Certifikues

1. Këshilli është autoriteti përgjegjës, i cili pajis me certifikatë individuale për ushtrimin e profesionit të përkthyesit dhe/apo përkthyesit dhe interpretit gjyqësorë personat fizik që kërkojnë të ushtrojnë veprimtarinë si përkthyes dhe/apo përkthyes dhe interpret gjyqësorë i certifikuar dhe emëruar, në përputhje me rregullat dhe procedurat e parashikuara në këtë rregullore.

2. Shërbimi i përkthyesit dhe/apo përkthyesit dhe interpretit gjyqësorë në procedura gjyqësore organizohet nën mbikëqyrjen e Këshillit, i cili kujdeset dhe mbështet kryerjen e shërbimit me profesionalizëm dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

## KAPITULLI II

## THEMELIMI, PËRGJEGJËSIT DHE KOMPENSIMI I KOMISIONEVE, UDHËHEQËSI I ZYRËS SË PËRKTHIMEVE DHE PËRGJEGJËSIT E TIJ

### Neni 7
### Komisioni Përzgjedhës

1. Këshilli në bazë të kritereve të përcaktuara me këtë rregullore themelon Komisionin përzgjedhës.

2. Komisioni përzgjedhës përbëhet nga tre (3) anëtarë të rregullt dhe dy (2) anëtarë rezervë, të cilët zgjidhen me mandat dy (2) vite, me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat tjetër. Këshilli zgjedh kryetarin e komisionit nga radhët e anëtarëve të rregullt të këtij komisioni.

3. Gjatë vendosjes për përbërjen e komisionit përzgjedhës, Këshilli merr parasysh parimin e barazisë gjinore dhe përfaqësimin e komuniteteve jo shumicë.

4. Për t'u emëruar anëtarë i komisionit përzgjedhës duhet të plotësohen njëri nga kriteret si në vijim:

4.1.të jetë profesionist, apo të ketë ushtruar punën e përkthyesit në çiftin e gjuhëve jo më pak se pesë (5) vite;
4.2.të ushtroj profesionin e profesorit të gjuhës në të cilën kërkohet certifikimi, jo më pak se pesë (5) vite;
4.3.jurist me të paktën pesë (5) vite përvojë pune apo gjyqtar të cilët janë njohës i çiftit të gjuhëve për të cilat mbahet provimi;
4.4. të jetë përfaqësues i organizatave ndërkombëtare të cilat ofrojnë kurse në gjuhën përkatëse; si dhe,
4.5.përjashtimisht nën paragrafit 4.1 dhe 4.2, në rast se paraqitet nevoja për certifikim të përkthyesit apo interpretit të çiftit të gjuhës me kuadro deficitar, Këshilli mund të emëroj për anëtarë të komisionit edhe profesionistët me përvojë pune me më pak se pesë (5) vite.

5. Anëtari i komisioni përzgjedhës duhet të këtë njohuri për çiftin e gjuhëve të nivelit që mundëson vlerësimin e kandidatit në atë çift gjuhësh.

## Neni 8
## Përgjegjësitë e Komisionit Përzgjedhës

1. Komisioni përzgjedhës është përgjegjës për sigurimin e mbarëvajtjes së procedurës së përzgjedhjes së kandidateve për certifikim dhe emërim të përkthyesve dhe/apo përkthyesve dhe interpretëve gjyqësorë, për formulimin e pyetjeve të provimit me shkrim dhe me gojë, vlerësimin, hartimin e raportit dhe dërgimin e listës përfundimtare të kandidatëve për certifikim dhe emërim në Këshill.

2. Komisioni përzgjedhës ndërmerr masa dhe siguron që provimi të mbetet konfidencial deri në momentin e mbajtjes së provimit.

3. Shkelja e konfidencialitetit sipas paragrafit 2 të këtij neni për subjekte bartëse të procesit konsumon shkelje të përgjegjësisë disiplinore dhe veprës penale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

## Neni 9
## Komisioni për Rishqyrtim

1. Këshilli themelon Komisionin për Rishqyrtim në përbërje prej tre (3) anëtarëve të rregullt si dhe dy (2) anëtar rezervë të cilët caktohen nga radhët e gjyqtarëve të gjykatave të Republikës së Kosovës, të cilët zgjidhen me mandat dy (2) vite, me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat tjetër.

2. Gjatë vendosjes për përbërjen e Komisionit për Rishqyrtim, Këshilli merr parasysh parimin e barazisë gjinore dhe përfaqësimin e komuniteteve jo shumicë.

3.Komisioni për Rishqyrtim është përgjegjës për shqyrtimin e ankesave të kandidatëve ndaj vendimeve të Komisionit përzgjedhës.

4. Këshilli zgjedh kryetarin e komisionit nga radhët e anëtarëve të rregullt të Komisionit për Rishqyrtim.

## Neni 10
## Udhëheqësi i zyrës së përkthimeve dhe përgjegjësit e tij

1. Udhëheqësi i zyrës së përkthimeve kryen njëkohësisht edhe detyrën e sekretarit të Komisionit Përzgjedhës dhe Komisionit për Rishqyrtim sipas kësaj rregullore dhe është përgjegjës për ofrimin e mbështetjes profesionale dhe administrative në punët e nevojshme për mbajtjen e provimit dhe certifikimin e kandidateve, në përjashtim të rasteve kur udhëheqësi i zyrës së përkthimeve caktohet në cilësinë e anëtarit të komisionit në ndonjërin prej komisioneve të parapara me këtë rregullore.

2.Në rastet kur udhëheqësi i Zyrës se Përkthimeve caktohet anëtar në ndonjërin nga komisionet e parapara me këtë rregullore, me vendim të drejtorit të përgjithshëm, sekretar i komisionit për atë komision caktohet një zyrtar tjetër.

3.Udhëheqesi i Zyrës së Përkthimeve është përgjegjës për mirëmbajtjen e dosjeve dhe regjistrit të përkthyesit dhe/apo përkthyesit dhe interpretit gjyqësorë të certifikuar dhe emëruar si dhe me

autorizimin e drejtorit të përgjithshëm kryen të gjitha procedurat që ndërlidhen me certifikim dhe emërim.

4. Në momentet kur vëllimi i punëve rritet, sekretari i komisionit ka të drejtë të kërkoj nga drejtori i përgjithshëm ndihmë në aspektin e resurseve njerëzore. Drejtori i Përgjithshëm me vendim cakton zyrtarë të tjerë të cilët e ndihmojnë sekretarin e komisionit gjatë kohës kur zhvillohet procesi certifikimit dhe emërimit, i paraparë sipas kësaj rregullore.

**Neni 11**
**Konflikti i Interesit**

1. Konflikti interesit paraqet çdo rrethanë e cila për subjektet bartëse të procesit, do të konsiderohej si interes privat që ndikon, mund të ndikoj ose duket se do të ndikoj në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tyre, ashtu siç përcaktohet me Ligjin Nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

2.Subjektet bartëse të procesit duhet të bëjnë përpjekje ta parandalojnë dhe/ose t'i shmangen çfarëdo situate të konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të detyrave të tyre. Shfaqja e ndonjë konflikt interesi do të jetë po aq e dëmshme për respektin e publikut për punën e kryer nga Këshilli sikur edhe vet konflikti aktual i interesit.

3. Në rast se gjatë procesit të certifikimit, ndonjë subjekt bartës i procesit beson se mund të këtë konflikt interesi, ai duhet ta njoftoj menjëherë me shkrim për këtë çështje kryetarin e komisionit përkatës, i cili pas verifikimit të konfliktit të mundshëm të interesit vendos për përjashtimin dhe zëvendësimin e tij.

4.Në rast se konflikti i interesit lidhur me procesin e certifikimit, paraqitet nga kryetarët e komisioneve përkatëse, të njëjtit me shkrim e njoftojnë Këshillin, i cili pas verifikimit të konfliktit të mundshëm të interesit vendos për përjashtimin dhe zëvendësimin e tij.

5. Subjektet bartëse të procesit, me rastin e paraqitjes së konfliktit të mundshëm të interesit detyrohen që menjëherë të pezullojnë çfarëdo veprimi të mëtejmë, deri sa të vendoset lidhur me përjashtimin dhe zëvendësimin e tij, sipas përcaktimit të bërë me paragrafin 3 dhe 4 të këtij neni.

6. Në rast se subjektet bartëse të procesit sipas këtij neni gjenden në një situatë të konfliktit të interesit me ndonjë kandidat dhe një fakt të tillë e kanë mbajtur të fshehur, për subjektin bartës të procesit, tërheq përgjegjësi disiplinore apo me largim nga komisioni.

**Neni 12**
**Kompensimi i komisioneve**

Komisionet e parapara në këtë rregullore, lidhur me punën e tyre kompensohen siç përcaktohet me legjislacionin në fuqi dhe aktet e miratuara nga Këshilli.

## KAPITULLI III

## KRITERET, SHPALLJA E KONKURSIT, PËRZGJEDHJA, CERTIFIKIMI DHE EMERIMI I PËRKTHYESVE DHE/APO PËRKTHYESVE DHE INTERPRETËVE GJYQËSORË

### Neni 13
### Kriteret

1. Për t'u certifikuar dhe emëruar si përkthyes dhe/apo përkthyes dhe interpret gjyqësorë, kandidati duhet t'i plotësojë këto kushte të përgjithshme:

1.1.të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;

1.2.të ketë diplomë universitare e vlefshme në Republikën e Kosovës;

1.3.të ketë zotësi të veprimit;

1.4.të mos jetë i dënuar për vepër penale, në përjashtim të veprave penale të kryera nga pakujdesia;

1.5.të ketë së paku dy (2) vite përvojë pune si përkthyes, interpret ose si mësimdhënës i gjuhës përkatëse me kualifikim universitar;

1.6. të mos ketë të shqiptuar masë disiplinore të revokimit të certifikatës dhe shlyerjes nga regjistri i përkthyesit dhe/apo përkthyesit dhe interpretit gjyqësor në dy (2) vitet e fundit nga institucioni gjegjës i cili e ka certifikuar dhe emëruar si përkthyes dhe/apo si përkthyes dhe interpret.

### Neni 14
### Shpallja e konkursit

1. Këshilli shpall konkursin për certifikim dhe emërim për përkthyes dhe/apo përkthyes dhe interpret gjyqësor në faqen zyrtare të Këshillit.

2. Këshilli vendos për kohën e shpalljes së konkursit për çifte gjuhësh, varësisht prej nevojës dhe kërkesës.

3. Afati i konkursit të hapur me qëllim të aplikimit caktohet me vendim të Këshillit dhe nuk mund të jetë me i shkurtër se pesëmbëdhjetë (15) ditë.

### Neni 15
### Aplikimi

1. Aplikacioni së bashku me dokumentet mbështetëse dorëzohet në Këshill në formë fizike, i cili regjistrohet dhe secili kandidat pajiset me një konfirmim mbi pranimin e aplikacionit.

2. Aplikacioni i kandidatit duhet të jetë i plotësuar qartë, nëse kërkon të certifikohet dhe emërohet vetëm si përkthyes dhe/apo si përkthyese dhe interpret gjyqësorë, duke përcaktuar çiftin e gjuhës për të cilën aplikon për t'u certifikuar dhe emëruar.

3. Kandidati mund të aplikoj për certifikim dhe emërim për më shumë se një çift gjuhësh, duke plotësuar aplikacionin përkatës për secilin çift gjuhesh që aplikon.

4. Kandidati i cili aplikon për tu certifikuar si përkthyes dhe/apo përkthyes dhe interpret gjyqësorë për një çift gjuhësh duhet të paguaj taksën prej pesëdhjetë (50) euro, e cila pagesë duhet të dorëzohet bashkë me aplikacionin. Në rast të refuzimit të aplikacionit, taksa e paguar nuk rimbursohet.

5. Për secilin kandidat krijohet dosje e cila përmban të gjitha dokumentet e prezantuara nga kandidati. Komisioni përzgjedhës dhe sekretari janë përgjegjës për formimin dhe mbajtjen e dosjes ku sigurojnë kompletimin dhe përditësimin e saj deri në momentin e përmbylljes përfundimtare të procesit të certifikimit dhe emërimit.

6.Vetëm kandidatët e regjistruar në Këshill, në afatin e paraparë me konkurs për aplikim dhe dokumentacion të kompletuar, kanë të drejtë t'i nënshtrohen procesit te certifikimit dhe emërimit. Ndërsa, kandidatët të cilët nuk kanë aplikuar brenda afatit të paraparë në konkurs, si dhe ata të cilët kanë aplikuar në afat, por nuk e kanë dorëzuar dokumentacionin e kompletuar, sipas kritereve dhe kërkesave të konkursit nuk do të merren parasysh.

## Neni 16
## Përzgjedhja preliminare

1. Komisioni përzgjedhës, në një afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve shqyrton të gjitha aplikacionet e pranuara. Kandidati i cili i plotëson kriteret sipas konkursit të shpallur, do të njoftohet përmes faqes zyrtare të Këshillit dhe adresës elektronike të tij.

2. Në rast të refuzimit të aplikacionit, kandidati ka të drejtë ankese, në afat prej pesë (5) ditëve nga dita e pranimit të vendimit dhe të njoftimit në faqen zyrtare e Këshillit.

3. Ankesa e kandidatit shqyrtohet nga Komisioni për Rishqyrtim, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e përfundimit të afatit për ankesë.

4. Pas shqyrtimit të ankesës nga ana e Komisionit për Rishqyrtim, Këshilli përmes faqes zyrtare dhe adresës elektronike të kandidatit, njofton kandidatin i cili i plotëson kushtet për t'iu nënshtruar provimit me shkrim apo me gojë.

5. Njoftimi përmban listën me emër dhe mbiemër të kandidateve, kohën, datën, vendin, dhe të dhënat tjera rreth organizimit të provimit.

## Neni 17
## Administrimi i provimit me shkrim

1. Siç është përcaktuar me këtë rregullore, provimit mund t'i nënshtrohet vetëm kandidati nga lista e cila është publikuar në njoftimin e Këshillit.

2. Provimi drejtohet dhe mbikëqyret nga Komisioni përzgjedhës, i mbështetur nga sekretari i komisionit dhe Sekretariati.

3. Pjesë përbërëse e kësaj rregullore është udhëzuesi me rregullat e provimit për kandidatë.

4. Shkelja e rregullave të përcaktuara në udhëzuesin për rregullat e provimit nga ana e kandidatit, rezulton me diskualifikimin e tij dhe shpalljen e provimit të pavlefshëm për të.

5. Provimi me shkrim zgjatë njëqind e njëzetë (120) minuta. Gjatë provimit, kandidatit nuk i lejohet të ketë afër vetes asgjë përveç testit, fjalorit dhe stilolapsit.

6. Nëse kandidati nuk paraqitet në kohën e caktuar për provim ose nëse para fillimit të provimit deklaron se heq dorë, konsiderohet se ai nuk iu ka nënshtruar provimit.

7. Kandidati i cili heq dorë pasi që të ketë filluar provimin, konsiderohet se ka rënë nga provimi.

8. Testin e provimit me shkrim, të përfunduar, kandidati do ta vendos në plikon e formatit A-4 dhe do ta mbyllë atë, ndërsa në fletën që do vendos në plikon e formatit A-6 do të shkruaj emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin të cilën poashtu e mbyllë. Që të gjitha këto veprime do t'i bëjë në prani të komisionit. Këto dy pliko do të lidhen (ngjiten) në mes vete dhe pas përfundimit në tërësi të provimit me shkrim, komisioni do të vendosë kodet në pliko të cilat do të veçohen njëra prej tjetrës.

**Neni 18**

**Vlerësimi dhe shpallja e rezultateve të provimit me shkrim**

1. Komisioni Përzgjedhës bënë vlerësimin e provimit me shkrim.

2. Provimi me shkrim mund të vlerësohet deri në njëqind (100) pikë. Nëse kandidati në provim arrin së paku shtatëdhjetë (70) pikë, konsiderohet se e ka kaluar provimin.

3. Çdo element i provimit me shkrim mund të vlerësohet me pikët maksimale sipas këtyre kritereve:

3.1. përkthimi nga gjuha A në gjuhën B, deri në tridhjetë (30) pikë;

3.2. përkthimi nga gjuha B në gjuhën A, deri në tridhjetë (30) pikë;

3.3. njohuritë e terminologjisë juridike deri në dyzetë (40) pikë.

4. Secili anëtar i komisionit përzgjedhës, vlerëson provimin me shkrim të secilit kandidat në mënyrë të pavarur dhe të paanshme duke respektuar kriteret nga paragrafi 3 i këtij neni dhe duke përdorur formularin për vlerësim nga anëtari i komisionit të provimit me shkrim për certifikim dhe emërim të kandidatit për përkthyes dhe/apo përkthyes dhe interpretit gjyqësorë.

5. Në formularin e vlerësimit nga Komisioni Përzgjedhës vendosen pikët e secilit anëtar të komisionit të cilat në rubrikën përfundimtare të formularit mblidhen dhe pjesëtohen për tre (3), duke dhënë rezultatin përfundimtar për kandidatin e vlerësuar.

6. Të gjithë formularët si ata individual dhe formulari i vlerësimit nga Komisioni Përzgjedhës nënshkruhen nga komisioni.

7. Komisioni përzgjedhës në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e mbajtjes së provimit me shkrim, publikon listën preliminare të kandidatëve në faqen e Këshillit duke i renditur me emër, mbiemër dhe numrin e pikëve të fituara si dhe i njofton kandidatin përmes adresës elektronike që ka kaluar provimin me shkrim.

8. Lista përfundimtare shpallet nga ana e komisionit në faqen zyrtare të Këshillit pas përfundimit të procedurës së ankesës të përcaktuar në nenin 21 të kësaj rregullore.

**Neni 19**
**Provimi me gojë**

1. Kandidatët të cilët e kanë kaluar provimin me shkrim si përkthyes dhe kanë aplikuar që të certifikohen dhe emërohen si interpret duhet t'i nënshtrohen provimit me gojë.

2. Vendin dhe kohën e mbajtjes së provimit me gojë e cakton Komisioni Përzgjedhës në afat jo më larg se shtatë (7) ditë pas publikimit të rezultateve përfundimtare të provimit me shkrim.

3. Provimi mbahet para komisionit për atë çift gjuhësh në përputhje me rregullat e përcaktuar nga ana e Komisionit.

**Neni 20**
**Vlerësimi dhe shpallja e rezultateve të provimit me gojë**

1. Provimi me gojë vlerësohet deri në njëqind (100) pikë. Konsiderohet se kandidati ka kaluar provimin nëse arrin së paku shtatëdhjetë (70) pikë.

2. Çdo element i provimit me gojë mund të vlerësohet me pikët maksimale sipas këtyre kritereve:

2.1. përkthimi nga gjuha A në gjuhën B, deri në njëzet (20) pikë;

2.2. përkthimi nga gjuha B në gjuhën A, deri në njëzet (20) pikë;

2.3.njohuritë e terminologjisë juridike deri në dyzetë (40) pikë;

2.4.formulimi i fjalisë, shpejtësia e përkthimit, terminologjia adekuate, deri në njëzet (20) pikë.

3. Secili anëtar i Komisionit Përzgjedhës, vlerëson provimin me gojë të secilit kandidat në mënyrë të pavarur të paanshme duke respektuar kriteret nga paragrafi 2 i këtij neni dhe duke përdorur formularin për vlerësim nga anëtari i komisionit të provimit me gojë për certifikim dhe emërim të kandidatit për përkthyes dhe/apo përkthyes dhe interpretit gjyqësorë.

4. Në formularin e vlerësimit nga Komisioni Përzgjedhës vendosen pikët e secilit anëtar të komisionit të cilat në rubrikën përfundimtare të formularit mblidhen dhe pjesëtohen për tre (3), duke dhënë rezultatin përfundimtar për kandidatin e vlerësuar

5. Të gjithë formularët si ata individual dhe formulari i vlerësimit nga Komisioni Përzgjedhës nënshkruhen nga komisioni.

6. Komisioni, publikon listën preliminare të kandidatëve të cilët e kanë kaluar provimin me gojë në faqen e Këshillit duke i renditur me emër, mbiemër dhe numrin e pikëve të fituara si dhe i njofton kandidatin përmes adresës elektronike që ka kaluar provimin me gojë.

7. Lista përfundimtare shpallet nga ana e komisionit në faqen zyrtare të Këshillit pas përfundimit të procedurës së ankesës të përcaktuar në nenin 21 të kësaj rregullore.

**Neni 21**
**E drejta në ankesë**

1. Kandidati i pakënaqur me rezultatin ka të drejtë ankese për të kundërshtuar procesin, lidhur me shkeljen e rregullave, rreth organizimit të provimit si dhe rezultateve të provimit me shkrim dhe provimit me gojë në afat prej tre (3) ditëve, nga dita e shpalljes së rezultateve, mbi bazën e njoftimit të bërë sipas kësaj rregullore.

2. Ankesa e kandidatit sipas paragrafit 1 të këtij neni, shqyrtohet nga Komisioni për Rishqyrtim, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e përfundimit të afatit të ankesës.

3. Në rast se Komisioni për Rishqyrtim, pas vlerësimit të ankesës gjen se janë bërë shkelje të rregullave rreth organizimit të provimit me shkrim dhe provimit me gojë siç është përcaktuar me këtë rregullore, mund të marrë vendim që të përsëritet pjesa e kundërshtuar e provimit të cilës do t'i nënshtrohen kandidatet nga lista që kanë plotësuar kushtet për të iu nënshtruar pjesës gjegjëse të provimit.

4. Nëse, Komisioni për Rishqyrtim vendosë që të përsëritet pjesa përkatëse e provimit, provimi organizohet brenda pesë (5) ditëve, nga vendimi i Komisionit për Rishqyrtim. Me këtë rast, Komisioni Përzgjedhës, do të hartoj testin e ri, rezultatet e të cilit do të merren parasysh me rastin e përpilimit të listës përfundimtare të provimit.

5. Në rast se Komisioni për Rishqyrtim, gjen se janë bërë gabime teknike, me rastin e llogaritjes së pikëve të provimit me shkrim dhe provimit me gojë, ndërsa me rastin e shqyrtimit të ankesës vërtetohet se kandidati renditet në grupin e kandidatëve që nuk e kanë kaluar pjesën përkatëse të provimit, ai kandidat do të futet në listën e kandidatëve që e kanë kaluar atë pjesë të provimit.

6. Pas shqyrtimit të ankesave për provimin me shkrim dhe provimin me gojë, komisioni përzgjedhës përpilon listën përfundimtare të provimit, e cila publikohet në faqen zyrtare të Këshillit siç përcaktohet me këtë rregullore.

## Neni 22
## Raporti përfundimtar i vlerësimit

1. Komisioni përzgjedhës në bashkëpunim me sekretarin e komisionit pas përfundimit të procesit përgatit raportin përfundimtar të vlerësimit të provimit me shkrim dhe raportin përfundimtar vlerësimit të provimit me gojë në të cilët përshkruhet e tërë rrjedha e procesit lidhur me kandidatin për certifikim dhe emërim për përkthyes dhe/apo përkthyes dhe interpret gjyqësor.

2. Raportet përfundimtare sipas paragrafit 1 të këtij neni i dorëzohen Këshillit.

## Neni 23
## Certifikimi dhe emërimi i kandidatëve

1. Jo më vonë së pesëmbëdhjetë (15) ditë pas përfundimit të procedurës së ankesës, Komisioni përzgjedhësi dërgon Këshillit raportin përfundimtar të vlerësimit të kandidatëve për përkthyes dhe/apo përkthyes dhe interpret gjyqësorë të cilët i plotësojnë kushtet sipas kësaj rregullore.

2. Këshilli, pas shqyrtimit dhe miratimit të raportit përfundimtar të vlerësimit të kandidatëve të propozuar nga Komisioni Përzgjedhës, me vendim i certifikon dhe emëron përkthyesit dhe/apo përkthyesit dhe interpretet gjyqësorë.

3. Kandidati, pasi që të kaloi provimin me shkrim, me gojë, apo të dyja, për tu certifikuar dhe emëruar si përkthyes gjyqësorë për një çift gjuhësh obligohet ta paguaj taksën prej njëqind (100) euro, ndërsa kandidati për t'u certifikuar dhe emëruar edhe si interpret gjyqësorë për një çift gjuhësh paguan taksën prej dyqind (200) euro, e cila taksë përfshin edhe taksën për përkthyes gjyqësorë. Kjo pagesë duhet të bëhet brenda shtatë (7) ditëve nga shpallja e listës përfundimtare të kandidatëve në faqen zyrtare të Këshillit.

4. Këshilli lëshon certifikatën për kandidatët të cilët kanë dhënë provimin dhe e kanë bërë pagesën e taksës sipas paragrafit 3 të këtij neni, jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas kalimit të afatit për pagesën e taksës.

5. Certifikata përmban:

5.1. logon e institucionit që lëshon certifikatën;
5.2.numrin dhe datën kur është lëshuar certifikata;
5.3.llojin e certifikimit duke përfshirë edhe çiftin e gjuhëve ;
5.4.emrin, emrin e prindit, mbiemrin dhe numrin personal;
5.5 nënshkrimin e Kryesuesit të Këshillit; dhe
5.6 vulën zyrtare.

## Neni 24
## Kartela identifikuese dhe vula

1. Çdo përkthyes dhe/apo përkthyes dhe interpret gjyqësorë i certifikuar dhe emëruar duhet të këtë kartelë identifikuese dhe vulë. Formati i kartelës dhe vulës përcaktohet nga Këshilli.

2. Kartela e përkthyesit dhe/apo përkthyesit dhe interpretit gjyqësorë të certifikuar dhe emëruar lëshohet nga Këshilli dhe duhet të përmbaj:

2.1. logon e institucionit që e certifikon dhe emëron;
2.2. numrin e certifikatës;
2.3. emrin dhe mbiemrin;
2.4. foton; dhe
2.5. llojin e certifikimit duke përfshirë edhe çiftin e gjuhëve.

3. Vula duhet të jetë për çiftin e gjuhëve për të cilën është certifikuar në dy (2) gjuhë zyrtare të Republikës së Kosovës.

4. Teksti i vulës shkruhet me shkronja të mëdha të shtypit në madhësi dhe formë të njëjtë në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.

5. Vula duhet të jetë e rrumbullakët, me diametër 40 mm, në të cilën duhet të shënohet:

5.1. në rrethin e parë: Republika e Kosovës / Republika Kosovo;
5.2. në rrethin e dytë: përkthyes gjyqësor dhe/apo përkthyes dhe interpret gjyqësor /sudski prevodilac ili sudski prevodilac i tumač;
5.3. në rrethin e tretë: emri dhe mbiemri i përkthyesit/interpretit;
5.4. në rrethin e katërt: çiftin e gjuhëve për të cilën është certifikuar.

6. Shpenzimet për pajisje me vulë i bartë vetë përkthyesi dhe/apo përkthyesi dhe interpreti gjyqësorë i certifikuar dhe emëruar.

7. Përkthyesi dhe/apo përkthyesi dhe interpreti gjyqesorë i certifikuar dhe emëruar duhet ta deponoj nënshkrimin dhe kopjen e vulës në Këshill. Përshtatshmërisht, kur të krijohen kushtet, përkthyesi dhe/apo përkthyesi dhe interpreti gjyqësorë i certifikuar dhe emëruar mund të deponoj nënshkrimin dhe vulën elektronike.

8. Përmbajtja e tekstit standard që vërteton saktësinë e përkthimit sigurohet nga Këshilli për të gjithë përkthyesit dhe/apo përkthyes dhe interpretët gjyqësorë të certifikuar dhe emëruar.

### Neni 25
### Regjistri

1. Përkthyesi dhe/apo përkthyesi dhe interpreti gjyqësorë regjistrohet në regjistrin e përkthyesve dhe interpretëve të certifikuar dhe emëruar nga Këshilli.

2. Regjistri i përkthyesve dhe/apo përkthyesve dhe interpretëve gjyqësor të certifikuar dhe emëruar përmban të gjitha informatat kontaktuese dhe informatat e tjera rreth tyre, duke përfshirë edhe çiftin e gjuhës për të cilin është kompetent.

3. Përkthyesi dhe/apo përkthyesi dhe interpreti gjyqësorë i certifikuar dhe emëruar duhet ta njoftojnë menjëherë Këshillin për çdo ndryshim të të dhënave të përfshira në regjistër.

4. Regjistri publikohet në faqen zyrtare të Këshillit dhe administrohet nga Sekretariati i Këshillit.

### Neni 26
### Çifti i gjuhëve që nuk janë mbuluar

1.Në rastet kur në regjistrin e përkthyeseve dhe/apo përkthyes dhe interpretëve gjyqësorë të certifikuar dhe emëruar, nuk ka përkthyes dhe/apo përkthyes dhe interpret gjyqësorë për atë çift gjuhësh, atëherë gjykata apo institucioni përkatës mund të angazhoj përkthyes dhe/apo përkthyes dhe interpretë të jashtëm apo njohës të gjuhës për çiftin e gjuhës të pambuluar.

2. Përjashtimisht, në raste të veçanta, gjykata mund të angazhoj përkthyes të pa certifikuar dhe emëruar nga Këshilli, kur ajo gjuhë nuk është gjuhë për të cilën është kërkuar përkthyes dhe/apo përkthyes dhe interpret gjyqësorë më parë. Para angazhimit të përkthyesit, gjykata e kërkon ndihmën e Këshillit për të identifikuar apo angazhuar përkthyesin.

3. Këshilli e mban/rezervon të drejtën për kërkimin e ndihmës nga autoritetet kompetente të shteteve tjera për sigurimin e përkthyesve në gjuhën përkatëse.

## KAPITULLI IV

## TË DREJTAT, DETYRIMET DHE KOMPENSIMI PËR PËRKTHYES DHE/APO PËRKTHYES DHE INTERPRET GJYQËSOR

### Neni 27
### Të drejtat dhe detyrimet

1. E drejta për ushtrimin e profesionit të përkthyesit dhe/apo përkthyesit dhe interpretit gjyqësor të certifikuar dhe emëruar fillon nga çasti i marrjes së certifikatës, pajisjes me kartelë, vulë dhe regjistrimit në regjistër.

2. Përkthyesi dhe/apo përkthyesi dhe interpreti gjyqësorë i certifikuar dhe emëruar gëzon të drejtën e kompensimit për punën e kryer në përputhje me këtë rregullore.

3. Përkthyesi dhe/apo përkthyesi dhe interpreti gjyqësorë i certifikuar dhe emëruar ka detyrim që:

3.1.të mos refuzoj kryerjen e një shërbimi, përveç rasteve kur gjenden në kushte papajtueshmërie ose konflikti interesi dhe përjashtimisht për shkak të pamundësisë për kryerjen e përkthimit dhe interpretimit me profesionalizëm dhe brenda afatit të kërkuar;

3.2. të ruaj sekretin profesional dhe konfidencialitetin e të dhënave, për të cilat është vënë në dijeni nga faktet, rrethanat apo dokumentet e vëna në dispozicion gjatë shërbimit, si dhe mban përgjegjësi për përkthimin ne pajtim me tekstin burimor apo të ndryshimit me dashje të përmbajtjes së tekstit;

3.3. të lexoj, rishkruaj dhe përkthej dokumente gjyqësore dhe jo gjyqësore, nga gjuha burimore në gjuhën e synuar, për nevojat e palëve në procedurë dhe gjykatës, duke ndjekur rregullat e vendosura që kanë të bëjnë me faktorë të tillë si kuptimi i fjalëve, struktura e fjalisë, gramatika, sintaksa dhe shenjat e pikësimit;

3.4. të kryej përkthime në procedurë gjyqësore nga gjuha burimore në gjuhën e synuar dhe anasjelltas, me gojë dhe me shkrim, brenda afateve të përcaktuara, duke siguruar që interpretimi dhe përkthimi të jetë në përputhshmëri të saktë me përmbajtjen leksikore, stilistike dhe semantike të origjinaleve;

3.5. të ndihmoj në komunikimin me personat në sallën e gjyqit, duke përfshirë palët avokatin, stafin e gjykatës dhe gjyqtarin në çdo gjë që thuhet pa shtuar, hequr dhe ndryshuar asgjë;

3.6. përmes përkthimit/interpretimit të saktë dhe të kujdesshëm tu mundësoj palëve që nuk janë folës burimorë apo të rrjedhshëm të të dyja apo njërës gjuhë zyrtare të Republikës së Kosovës ose një gjuhë zyrtare e Republikës së Kosovës dhe një gjuhë e huaj, qasje të barabartë para ligjit në gjuhën që ata e kuptojnë, si njëra ndër kushtet me elementare të mbrojtura me standardet më të larta të së drejtës.

3.7. të jetë i kujdesshëm në mosdhënien e këshillave ligjore dhe të kryejë veprimtarinë e tij me profesionalizëm, korrektësi, paanshmëri dhe integritet;

3.8. të respektoj Kodin e Etikës për Përkthyes dhe/apo Përkthyes dhe Interpret Gjyqësor të Certifikuar dhe Emëruar;

3.9. të përmbushë detyrimet sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve të Këshillit.

## Neni 28
## Kompensimi për përkthim - interpretim

1.Përkthyesi dhe/apo përkthyesi dhe interpreti gjyqësorë i certifikuar dhe emëruar do të kompensohet për shërbimet e dhëna sipas skemës së përcaktuar në këtë nen.

1.1. për përkthimin e dokumenteve në dy gjuhë zyrtare të Republikës së Kosovës ose një gjuhë zyrtare e Republikës së Kosovës dhe një gjuhë e huaj, si dhe nga njëra gjuhë

zyrtare në tjetrën, si dhe anasjelltas do të llogaritet çmimi prej 0.035 € për çdo fjalë të përkthyer;

1.2. për verifikim të përkthimit, që ka bërë një person tjetër, përkthyesit gjyqësor i takon gjysma e kompensimit nga paragrafi 1.1 i këtij neni.

2.Interpreti gjyqësorë i certifikuar dhe emëruar për interpretimin nga një gjuhë zyrtare e Republikës së Kosovës në një gjuhë të huaj, nga njëra gjuhë zyrtare në tjetrën dhe anasjelltas, si dhe nga një gjuhë e huaj në tjetrën, kompensohet për shërbimet e dhëna si në vijim:

2.1. për orën e filluar – dyzetë (40.00) euro deri në tridhjetë (30) minuta, duke llogaritur kohën e humbur për të ardhur dhe kthyer në vendin ku është kërkuar interpretimi;

2.2.për një orë intepretimi, përkatësisht përkthimi konsekutiv, simultant apo me pëshpëritje llogaritet shuma prej dyzetë (40.00) euro, përfshirë kohën e pauzës dhe pushimeve, ndërsa çdo orë shtesë në shumën prej njëzetë (20.00) euro për orë.

3. Në rastet kur kërkohet interpretim konsekutiv, simultant apo me pëshpëritje dhe personi është jashtë territorit të gjykatës kompetente, përkthyesit dhe interpretit gjyqësorë të certifikuar dhe emëruar i llogariten edhe shpenzimet e udhëtimit.

3.1. Mbi 10 km vajtje-ardhje llogaritet shuma prej 0.20 € për çdo kilometër shtesë.

4.Përkthyesit dhe/apo përkthyesit dhe interpretët gjyqësorë të certifikuar dhe emëruar kompensohet për shërbimin e ofruar brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve nga dita e dorëzimit të formularit në zyrën përkatëse.

## KAPITULLI V

## DSIPLINIMI, REVOKIMI I CERTIFIKATES DHE SHLYERJA NGA REGJISTRI

### Neni 29
### Inicimi i procedurës

1. Këshilli inicion procedurë disiplinore ndaj përkthyesit dhe/apo përkthyesit dhe interpretit gjyqësorë të certifikuar dhe emëruar, me kërkesë nga gjyqtari ose kryetarit i trupit gjykues në rastet kur:

1.1. përkthyesi dhe/apo përkthyesi dhe interpreti gjyqësorë i certifikuar dhe emëruar edhe pas vërejtjes dhe dënimit me gjobë të dhënë nga gjyqtari apo kryetarit i trupit gjykues, i njëjti vazhdon të përsëritë veprimet për të cilat i është dhënë vërejtja dhe dënimi me gjobë; si dhe,

1.2. ka pranuar ankesë të arsyetuar me shkrim nga pala në procedurë apo stafi i gjykatës dhe ka të dhëna të besueshme që përkthyesit dhe/apo përkthyesi dhe interpreti gjyqësorë i certifikuar dhe emëruar ka bërë shkelje të Kodit të Etikës për Përkthyes dhe/apo Përkthyes dhe Interpret Gjyqësor të Certifikuar dhe Emëruar.

2. Gjyqtari ose kryetari i trupit gjykues për inicimin e procedurës disiplinore parashtron kërkesë në Këshill duke i bashkangjitur të gjitha materialet në kompetencë të komisionit disiplinor.

3.Të drejtë për inicim të procedurës disiplinore përveç subjekteve të parapara ne paragrafin 1 të këtij neni ka edhe udhëheqësi i Zyrës së Përkthimeve në Sekretariat në rastet kur vjen në përfundim se përkthyesi dhe/apo përkthyesi dhe interpreti gjyqësorë i certifikuar dhe emëruar nuk i përmbahet detyrimeve të cilat përcaktohen me këtë rregullore.

4. Kërkesa për inicimin e procedurës disiplinore, regjistrohet në Zyrën e Pranimit të Sekretariatit dhe e njëjta dorëzohet tek sekretari i komisionit disiplinor për procedim të mëtutjeshëm.

**Neni 30**
**Themelimi i Komisionit Disiplinor dhe zhvillimi i procedurës**

